

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Data: 21.11.2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

X

“General Trading” sh.p.k me NUIS **M21501011F** dhe adresë: Tiranë Pezë, Zona kadastrale 2953, Nr. pasurie 72/28, Rruga Ben Mjalti, Njësia Administrative Pezë.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Mall**

Lloji i Procedurës së prokurimit: e Hapur, Marrëveshje Kuadër me afat 12-muaj

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-61639-09-16-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Blerje vegla Pune, E hapur, Mall**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **17.09.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Buletini nr.53 datë 22 Shtator 2025**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OPERATORI EKONOMIK “**KALIA**” SH.P.K

NIPT **L41320036L**

Vlera: **10.625.000** (dhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OPERATORI EKONOMIK “**BIOTEK**” SH.P.K

NIPT **L82203011N**

Vlera: **12.896.300** (dymbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OPERATORI EKONOMIK “**General Trading**” SH.P.K

NIPT **M21501011F**

Vlera: **11.260.650** (njëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **OPERATORI EKONOMIK “KALIA” SH.P.K**

L41320036L

Vlera: **10.625.000** (dhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa tvsh.

arsyet

Nuk i plotëson kriteret e veçanta për kualifikim përkatësisht:

Në zbatim të pikave 2.3.3 dhe 2.3.5 të kriterëve teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit (DST), operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka paraqitur në ofertën e tij dokumentet përkatëse të kërkuara, që përfshijnë “Ofertën Teknike” dhe skedat teknike për 10 produktet objekt prokurimi. Në këto dokumente operatori ka bërë deklarin e produkteve të ofertuara, duke bashkëngjitur katalogët përkatës të referuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe krahasimit të të dhënave të deklaruara nga operatori me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (DST), rezulton se operatori ekonomik KALIA sh.p.k. nuk përmbush specifikimet teknike për produktet e mëposhtme:

➤ **Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra**

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar në ofertën teknike produktin “Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra”, të markës KRAFT Agritech, duke referuar faqen nr. 27 të katalogut *KRAFT Agritech 2024–2025*, pjesa 3 nga 4, me kod 120359.

Ka ngarkuar në SPE dokumentin e emërtuar

“*Katalog_KRAFT_Agritech_2024_2025_Pjesa_3_nga_4.pdf*”, i cili përfshin produktin e referuar.

Në DST janë kërkuar këto specifikime teknike:

- Material: alumin ose ekuivalent;
- Lartësi: deri 3 m $\pm 5\%$;
- Kapacitet mbajtës: 150 kg $\pm 5\%$;
- Anti-rrëshqitje;
- Numër shkallësh: $2 \times 6 \pm 1$.

Katalogu i ngarkuar nuk përmban të dhëna teknike mbi materialin, lartësinë, kapacitetin mbajtës, karakteristikat antirëshqitje.

Për pasojë, artikulli “Shkallë profesionale alumini me palosje 3 metra” nuk përmbush specifikimet teknike.

- Mbledhëse mbeturinash me mekanizëm

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar produktin “Mbledhëse mbeturinash me mekanizëm”, duke referuar produktin Art. 807 në katalogun *IGEAX Aricasa*, faqe nr. 30. Ka ngarkuar në SPE dokumentin “*Igeax_Aricasa.pdf*”.

Në DST janë kërkuar:

- Set me fshesë + lopatë;
- Mekanizëm mbylljeje parabolike;
- Shkop alumini ose plastik rezistent;
- Përshtatshme për pastrim urban.

Në katalogun e ngarkuar nuk shënohen materiale, mekanizëm mbylljeje apo dimensione teknike — vetëm një foto ilustruese e produktit.

Për pasojë, artikulli “Mbledhëse mbeturinash me mekanizëm” nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara.

➤ **Lopatë teknologjike**

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar në ofertën teknike produktin “Lopatë teknologjike VOREL”, duke referuar faqen nr. 78 të katalogut *KRAFT Agritech 2024–2025*, pjesa 2 nga 4, me kod 35835.

Ka ngarkuar dokumentin “*Katalog_KRAFT_Agritech_2024_2025_Pjesa_2 nga_4.pdf*”.

Në DST janë kërkuar:

- Ngjyra: e zezë;
- Materiali i dorezës: plastik ose ekuivalent;
- Koka: çelik ose ekuivalent;
- Rezistencë për përdorim të gjatë.

Në katalogun e ngarkuar mungon përshkrimi mbi materialin e kokës (çelik ose ekuivalent), si dhe mungon çdo e dhënë për përmasat ose peshën.

Për pasojë, artikulli “Lopatë teknologjike” nuk përmbush plotësisht specifikimet teknike të kërkuara.

➤ **Komplet çelësa fiso 6–32 (set)**

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar në ofertën teknike produktin “Komplet çelësa fiso 4–32 (set)”, markat CONDOR+ dhe KISTENBERG, duke referuar faqen nr. 54 të katalogut *KRAFT 2024–2025 Pjesa 3 nga 4* (produkt CONDOR+ 35/25T) dhe faqen nr. 45 të katalogut *KRAFT Gjeneral 2025–2026 Pjesa 5 nga 7* (produkt KISTENBERG KEV5025AL).

Ka ngarkuar në SPE dokumentet përkatëse të të dy katalogëve.

Në DST janë kërkuar:

- Përmasa: 6–32 mm $\pm$ 1 mm;
- Material: krom-vanadium ose ekuivalent;

- Sistemi: AS-DRIVE ose ekuivalent;
Përfshin kapëse dhe kuti transporti.

Në katalogët e ngarkuar mungojnë të dhëna mbi sistemin AS-DRIVE, materialin e përbërësve, si dhe mungon konfirmimi për përfshirjen e të gjithë dimensioneve 6–32 mm.

Për pasojë, artikulli “Komplet çelësa fiso 6–32 (set)” nuk përmbush plotësisht specifikimet teknike.

➤ **Gur fresibël i vogël 850 W**

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar produktin “Gur fleksibël me reostat 900 W”, me kod AG900285, në faqen 75 të katalogut *KRAFT Agritech 2024–2025 Pjesa 1 nga 4*.

Ka ngarkuar dokumentin përkatës në SPE.

Në DST janë kërkuar:

- Fuqi: 850 W $\pm 5\%$;
- Rrotullime: 2800–11000 rpm $\pm 5\%$;
- Diametri diskut: 125 mm $\pm 5\%$;
- Pesha: rreth 1.6 kg $\pm 10\%$;
- Regjistër shpejtësie i përfshirë.

Në katalog jepet fuqi 900 W dhe diametër disku 125 mm, por mungon tërësisht të dhëna për peshën.

Për pasojë, artikulli përmbush vetëm pjesërisht specifikimet teknike.

➤ **Valixhe veglash**

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar produktin “Valixhe veglash KISTENBERG KHVW”, duke referuar faqen nr. 44 të katalogut *KRAFT Gjeneral 2025–2026 Pjesa 5 nga 7*.

Ka ngarkuar dokumentin përkatës në SPE.

Në DST janë kërkuar:

- Përmasa min. 450×360×640 mm $\pm 5\%$;
- Me rrota për transport të lehtë;
- Material: plastik rezistent ose metal i lehtë;
- Përdorim profesional.

Në katalog përfshihet përshkrim i përgjithshëm pa percaktuar peshë, apo material të trupit.

Për pasojë, artikulli “Valixhe veglash” nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara.

➤ **Pinca elektrike profesionale**

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar produktin “Pinca elektrike profesionale INGC0 HILNP28208 (200 mm)”, duke referuar faqen 105 të katalogut *KRAFT Agritech 2024–2025*

Pjesa 3 nga 4.

Ka ngarkuar në SPE dokumentin përkatës.

Në DST janë kërkuar:

- Tension izolimi: deri 1000 V $\pm 5\%$;
- Gjatësia: 8" $\pm 5\%$;
- Material: çelik i trajtuar termikisht ose ekuivalent;
- Dorezë ergonomike për siguri elektrike.

Në katalog jepet vetëm përshkrimi “Pinca elektrike 200 mm”, pa asnjë informacion për tension izolimi apo standard sigurie.

Për pasojë, artikulli “Pinca elektrike profesionale” nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara.

➤ Maskë për saldim me reze

Operatori ekonomik KALIA sh.p.k. ka deklaruar produktin “Maskë për saldim me reze INGCO AHM008”, duke referuar faqen 10 të katalogut *KRAFT Gjeneral 2025–2026 Pjesa 3 nga 7*, si dhe “Ekstrakt teknik AHM008” në website-in e rishitësit (pa dhënë adresë web).

Ka ngarkuar në SPE dokumentin përkatës.

Në DST janë kërkuar:

- Madhësia e fishekut: 110×90×9 mm $\pm 5\%$;
- Sensori i harkut: 2 ± 1 ;
- Klasa optike: 1/1/1/2 ose ekuivalente;
- Ndezje/fikje automatike.

Në katalog nuk janë të përfshira të dhënat mbi klasën optike, sensorët apo ndezjen automatike.

Për pasojë, artikulli “Maskë për saldim me reze” nuk përmbush specifikimet teknike.

Gjithashtu nga analiza e skedes teknike te artikujve të kërkuar në DST rezulton se katalogët e ngarkuar nuk janë katalogë origjinalë të prodhuesve sic kerkohet ne kriterin 2.3.3 ku përcaktohet “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit, për artikujt objekt prokurimi....*”, por katalogë tregtarë të kompanisë shpërndarëse (distributorit). Për pasojë, operatori ekonomik KALIA sh.p.k. nuk përmbush specifikimet teknike dhe kriterin 2.3.3 të DST-së, ndaj oferta e tij shpallet e pavlefshme.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

VLERA: 12.896.300 (DYMBËDHJETË MILION E TETËQIND E NËNTËDHJETË E GJASHTË MIJË E TREQIND) LEKË PA TVSH.

arsyet

Nuk i plotëson kriteret e veçanta për kualifikim.

Në përmbushje të pikave 2.3.4 të kriterëve teknikeku percaktohet “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose të distributorit të autorizuar, në rast se nuk është prodhues. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, nga prodhuesi për të gjitha artikujt si me poshte.....*” dhe 2.3.3 të kriterëve teknike ku percaktohet “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit, për artikujt objekt prokurimi si më poshtë*”, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të përcaktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit (DST), operatori ekonomik BIOTEK sh.p.k. ka paraqitur në ofertën e tij dokumentet përkatëse të kërkuara, si dhe “Ofertën Teknike” në zbatim të pikës 2.3.5 të kriterëve teknike.

Në këto dokumente operatori ka bërë deklarin e produkteve të ofertuara, duke bashkëngjitur katalogun “Katalogpdf.pdf”, të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si referencë për produktet e ofertës teknike.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe krahasimit të të dhënave të deklaruara nga operatori BIOTEK sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar “MUCA sh.p.k.”, e cila rezulton të jetë shoqëri tregtare distributore dhe jo prodhuese e produkteve të ofruara.

Në ofertën teknike të dorëzuar, operatori ka deklaruar shoqërinë MUCA sh.p.k. si prodhues, ndërkohë që nga verifikimi i dokumenteve dhe burimeve zyrtare rezulton se kjo shoqëri nuk është prodhues, por vetëm distributor tregtar.

Gjithashtu, operatori nuk ka dorëzuar asnjë autorizim të nënshkruar nga prodhuesit përkatës që të provojë se MUCA sh.p.k. është distributor i autorizuar për llogari të tyre.

Për këto arsye, operatori ekonomik “BIOTEK” SHPK nuk përmbush kërkesat e pikave 2.3.3 dhe 2.3.4 të kriterëve teknike për kualifikim të DST-së, pasi mungojnë skedat teknike ose kataloget e prodhuesve si dhe autorizimi i vlefshëm i prodhuesit ose prova e lidhjes ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Rrjedhimisht, oferta e operatorit ekonomik BIOTEK sh.p.k. konsiderohet e pavlefshme dhe skualifikohet.

Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 2.3.6 ku percaktohet “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuara nga autoriteti kontraktor përfitues*” duke qene se nuk ka paraqitur deklaratën në permbushje të këtij kriteri.

OE/BOE ME NËNKONTRAKTOR

PO ☐ JO ☒

NËSE PO, TË JEPEN DHËNAT _____

(EMRAT E NËNKONTRAKTORËVE, NIPT-ET, % E NËNKONTRAKTIMIT)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik “**General Trading**” sh.p.k me NUIS **M21501011F**, adresa: Tiranë Pezë, Zona kadastrale 2953, Nr. pasurie 72/28, Rruga Ben Mjalti, Njësia Administrative Pezë dhe me ofertë ekonomike **11.260.650** (njëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR